REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

(Viti 2026)

Nr. Rendor (1)	Data e kërkesës (2)	Objekti I kërkesës (3)	Data e përgjigjes (4)	Përgjigje (5)	Mënyra e përfundimit të kërkesës (6)	Tarifa (7)
1	05.01.2026	Kërkesa ka për objekt vënien në dispozicion të dokumentacionit zyrtar të Autoritetit Shtetëror të Kontrollit të Eksporteve (AKSHE), lidhur me zbatimin e detyrave dhe masave që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030, për periudhën gjashtë (6) mujore të parë pas hyrjes së saj në fuqi. Në mënyrë konkrete, kërkohet informacion dhe dokumentacion mbi: 1. Planin e punës dhe/ose planin e veprimit të institucionit (nëse ekziston), të hartuara për zbatimin e masave për të cilat institucioni është përgjegjës, sipas Udhërrëfyesit të Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030;	07.01.2026	Kërkuesi është informuar se ligji nr. 47/2025 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030" përcakton objektivat dhe fushën e veprimit të institucioneve përgjegjëse, sipas kompetencave ligjore. AKSHE është identifikuar si institucion përgjegjës për monitorimin dhe kufizimin e varësisë nga furnitorë të pasigurt në kuadër të Objektivit III. Është sqaruar se AKSHE ushtron veprimtarinë në zbatim të ligjit nr. 72/2019 dhe akteve nënligjore përkatëse, duke realizuar kontrollin, verifikimin, autorizimin dhe monitorimin e subjekteve dhe transaksioneve me rrezik për sigurinë kombëtare. Kërkesat e ligjit nr. 47/2025 janë të integruara në veprimtarinë e përditshme të Autoritetit dhe nuk ekziston detyrim ligjor për hartimin e një plani të veçantë masash. Funksionet realizohen në mënyrë të vazhdueshme përmes procedurave të kontrollit, analizës së riskut, raportimit dhe mbajtjes së regjistrave për rastet e dyshimta, sipas legjislacionit në fuqi.	E plotë	0

		2. Aktet administrative, dokumentet, procedurat dhe masat e ndërmarra nga institucioni në lidhje me shqyrtimin dhe/ose monitorimin e investimeve dhe kapitaleve të huaja, sektorëve kritikë, furnitorëve të pasigurt, si dhe raportimet periodike për këto çështje, për periudhën e sipërpërmendur. Kërkesa bazohet në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe synon marrjen e kopjeve të dokumenteve zyrtare përkatëse.				
2	28.04.2026	Informacion mbi kopjet e raporteve zyrtare mbi numrin e saktë të aplikimeve për licenca eksporti/importi/tranzitin në RSH të mallrave ushtarake dhe mallrave me përdorim të dyfishtë, që janë refuzuar, anuluar, ose revokuar në zbatim të sanksioneve ndaj Federatës Ruse (2022-2026). Informacion mbi dokumentacione statistikore apo raporte në lidhje me rastet e verifikuara, rastet e dyshimta dhe monitoruara nga AKSHE.	30.04.2026	Kërkuesi është informuar se nga AKSHE, nuk janë trajtuar aplikime për licenca eksporti/importi/tranzitin në RSH të mallrave ushtarake dhe mallrave me përdorim të dyfishtë, që janë refuzuar, anuluar, ose revokuar në zbatim të sanksioneve ndaj Federatës Ruse (2022-2026). Nuk janë regjistruar raste të dyshimta. Në vijimësi monitorohen të gjitha aplikimet dhe subjektet e përfshira në transferime të mallrave ushtarake dhe me përdorim të dyfishtë, duke u bazuar tek zbatimi i masave shtrënguese sipas ligjit Nr.72/2019 "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në RSH", i ndryshuar.	E plotë	0

** nuk ka kërkesa në muajin Shkurt, Mars, Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shator, Tetor, Nëntor.*

Shënim:

(1) Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve.
(2) Data e regjistrimit të kërkesës.
(3) Përmbledhje e objektit të kërkesës duke e anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
(4) Data e kthimit të përgjigjes.
(5) Përmbajtja e përgjigjes duke e anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
(6) Përgjigja jepet E plotë/E kufizuar/E refuzuar/E deleguar.
(7) Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.